



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 91, datë 20.02.2024

PËR

**CAKTIMIN E RELATORIT NË PROCEDURAT E VLERËSIMIT ETIK DHE
PROFESIONAL TË GJYQTARËVE TË PAPËRFUNDUAR
NGA Z. RIDVAN HADO**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 89 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimet të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 159, datë 05.04.2023 “Rregullat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale:

VENDOSI:

1. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, të papërfunduara nga z. Ridvan Hado, si më poshtë :

- a) Për gjyqtaren znj. {...}- Relatore znj. Irena Plaku;
- b) Për gjyqtaren znj. {...}- Relatore znj. Emona Muçi;
- c) Për gjyqtarin z. {...}- Relatore znj. Yllka Rupa;

2. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, të papërfunduara nga z. Ridvan Hado, si më poshtë :

- a) Për gjyqtarin z. {...}- Relatore znj. Irena Plaku ;
- b) Për gjyqtarin z. {...}- Relatore znj. Yllka Rupa;
- c) Për gjyqtaren znj. {...}- Relatore znj. Emona Muçi;
- d) Për gjyqtarin z. {...}- Relatore znj. Emona Muçi .

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR